



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e II-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 10 shkurt 2023 në  
sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 10:40.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Maxhuni, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollı dhe Fatmire Cecelia, (anëtarë të KPF -së).

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Shpëtim Zhegrova (Nënkyetar i Komunës), drejtoret e drejtive, Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na kanë ardhur edhe disa pikë shtesë për të cilat do të diskutojmë nëse do të kemi mundësi t'i shtojmë në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve në Komunën e Vushtrrisë;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kioskave nga druri për më pak se një vit;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës** – deklaroj se nuk është praktikë e mirë, por edhe kohëve të fundit nuk kanë ardhur shumë pika shtesë, por si muaj, shkurti ka qenë më i vështirë që të bëhen gati materialet. Kështu që ju kërkojmë falje për materialet që kanë ardhur me vonesë, por kërkojmë mirëkuptimin tuaj që këto pika të futen në rend të ditës që të shqyrtohen në KPF dhe të procedohen për kuvend.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – sa i përket pikave shtesë, dy pikat që na kanë ardhur në e-mail janë të rëndësishme dhe duhet të futen në rend të ditës. Lidhur me pikën për caktim të kahjeve të lëvizjes, ne si KPF nuk mund të japim asnjë alternativë aty për aty. Nëse e procedojmë si të tillë pa e shqyrtuar fare, dalim joserioz para kuvendit dhe para qytetarëve. Ai propozoi që kjo pikë të vjen në procedurë të rregullt për seancën e radhës të kuvendit. Për që ka nevojë të rirregullohet komunikacioni në komunën tonë është evidente, sepse e pata potencuar edhe më herët si kërkesë, bile ndoshta është vonë. Prandaj, në këtë moment e kemi të pamundur të japim kontributin tonë pa e analizuar, dhe rrjedhimisht mund edhe të gabojmë, por do të ishte mirë që të ketë edhe konsultim publik në ato zona ku pritet të bëhen ndryshime, tha ai.

Sa i përket <Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kioskave nga druri për më pak se një vit> duhet të përmirësohet emërtimi <kioskave> dhe të bëhet <kiosqeve>. Lidhur me këtë propozim, këtu po flitet për një pjesë të

vogël të shfrytëzuesve, pra vetëm për kiosqet nga druri. Ai tha se kuvendi duhet të merr vendim për lirim nga pagesa e taksës të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike që i kanë me qira pronat komunale, sepse situatë e rëndë është për të gjithë. Nëse marrim vendim t'i lirojmë të gjithë nga pagesa, nuk ka implikime të mëdha buxhetore, për arsyen se të hyrat vetanake edhe ashtu po shkojnë suficit çdo vit dhe se nuk rrezikohet buxheti. Propozimi im është që të riformullohet ky propozim – vendim dhe të bëhet liri i pagesës për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale (objekteve, tokave, kiosqeve nga druri)

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës** – sa i përket pikës për caktimin e kahjeve të rrugëve, është bërë propozimi nga Drejtoria për Shërbime Publike. Ai tha se e kemi menduar që të bëhet edhe një marrëveshje me UNHABITAT-in për caktim të kahjeve për të gjithë qytetin, por ndoshta pak më e jashtëzakonshme kjo pjesa e qendrës së qytetit, sepse është e ngufatur. Propozimi ka ardhur, le të diskutohet, është drejtori i pranishëm që mund të jap sqarime deri në kuvend. Por, kjo mund të shkojë edhe në konsultim publik, sepse nuk do të kalojë pa iu nënshtruar edhe kësaj procedure.

Lidhur me propozimin për lirim nga pagesa për të gjithë shfrytëzuesit e hapësirave publike dhe të qirambajtjes, edhe ne pajtohem që të bëhet kjo, por për të gjithë ata që janë më pak se një vit.

**Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** – deklaroi se lidhur me këtë çështje, i kanë ftuar bizneset për t'i dhënë propozimet e tyre. Për të gjitha rrugët kemi pasur një pajtim, përveç sheshit deri tek bankat, ka pasur hezitime.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tha se në planin e punës së kuvendit, ka qenë e planifikuar që këtë muaj të vjen propozim – vendimi për ndarjen e subvencioneve për vitin 2023, e cila nuk ka ardhur. Prandaj, ky propozim duhet të vjen, e më vonë mos të ketë arsyetime që nuk është votuar buxheti me kohë dhe mjetet kanë shkuar suficit, sepse vetë po i vononi.

Në seancën e kaluar u ngrit si çështje raporti i punës i Komitetit për Komunitete, prandaj mirë që ka ardhur në këtë mbledhje, edhe pse me vonesë.

Kemi kërkuar një sqarim lidhur me mospagesën e mëditjeve për seancën e dhjetorit 2022. Ajo çfarë kemi parë që na e keni dërguar është fakti që dikush nga sekretaria (dihet kush ka qenë ai) ka lajthitur me informata në drejtim të MAPL-së, duke e paraqitur lëshimin e seancës me një arsyetim që e kemi pasur <si bojkotim i seancës>. Ai tha se ekziston një provesverbal i asaj mbledhje, ku pothuajse se gjysma e tij është e përbërë prej fjalimeve të anëtarëve të kuvendit, që në fund si rezultat i mospajtimit për zbatimin e LVL-së kanë marrë vendim me lëshu mbledhjen. Prandaj, ka një dallim të madh dhe nuk besoj që është dashur dikush të ketë këso kompetenca, si dhe ju si kryesuese mos me qenë në dijeni se si po informohet MAPL-ja. Siç e kemi parë, MAPL-ja ua ka lënë juve në përgjegjësi çështjen e pagesës apo mospagesës së mëditjeve. Ideja është se atë ditë lëshimi i seancës është bërë përfakt se nuk është respektuar nenii 47 i LVL-së, i cili (siç e ka thënë edhe vetë MAPL-ja) iu mundëson anëtarëve të kuvendit që me shumicë votash ta fusin në rend të ditës pika shtesë brenda seancës së kuvendit, ku atë ditë nuk u fut në votim fare. Prandaj, kjo ka qenë arsyaja që e kemi lëshuar mbledhjen.

Është për keqardhje, se që nga data 29 dhjetor 2022 (kur është mbajtur seanca e kuvendit), përgjegjësi i sekretarisë nuk iu ka drejtuar MAPL-së deri më 12 janar 2023, që i bie se iu ka drejtuar tek pasi që ka kaluar koha e procedimit të ndryshimeve në listën e pagave. Pra, njëherë janë ndalu mëditjet pa ndonjë vendim, e pastaj është kërkuar sqarim nga MAPL-ja. Për mua personalisht nuk ka ndonjë ndikim jetik kjo çështje, por askush nuk besoj që ka të drejtë të luajë me dinjitetin e anëtarëve të kuvendit në këtë mënyrë, sepse është e padrejtë. Kurse, ju si kryesuese është dashur të paktën përmes postës elektronike t'iu kërkoni falje anëtarëve të kuvendit, të cilëve nuk iu është paguar mëditja.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – nuk po e di a nuk po i kuptioni procedurat apo ja keni dhënë vetes si synim që me çdo kusht ta sulmoni kryesuesen e kuvendit. Ua kam sqaruar në seancë të kuvendit dhe ua sqaroj sa herë të ka nevojë, se kryesuesja e kuvendit nuk është përgjegjës për mëditje. Përgjegjës për mëditje është sekretaria e kuvendit. Lidhur me këtë çështje jam pyetur se çka me vepru mëditjet e atyre që e kanë lëshuar seancën. Përgjigja ime ka qenë: Veproni sipas ligjit. Në momentin që e kam kuptuar që nuk i keni marrë mëditjet (më kanë thënë që janë pezulluar mëditjet), unë e kam kryer punën time. Në pyetjet që ti mi ke drejtuar përmes adresës elektronike, herë e kam parë veten si në gjyq e herë si në polici, e në fund më kishe pyetur se: A ndihesh ti fajtore? Dijeni pozicionin tim, dijeni pozicionin e juaj secili prej jush dhe më drejtoheni me pyetje për të cilat unë jam përgjegjëse. Mendoj se procedurat që më takojnë mua i kam ndjekur dhe prej që të realizohen dhe t'i merrni mëditjet ashtu siç ju takojnë. MAPL-ja ka deklaruar që çështja e kompensimit të anëtarëve të kuvendit mbetet në kompetencën e kryesueses së kuvendit. Në momentin që ka ardhur shkresa nga MAPL-ja (ku thuhej mbetet në kompetencën e kryesueses së kuvendit) i kam bërë kërkësë me shkrim sekretarisë dhe kam kërkuar që t'i paguhen mëditjet anëtarëve të kuvendit edhe për atë seancë. Prandaj, procedurat ligjore që më takojnë si kryesuese i kam ndjekur dhe nuk e ndjej veten të nevojshme për të kërkuar falje. Në momentin që kisha bërë diçka për ta dëmtuar dikë, jam shumë e gatshme të kërkoj falje ndaj çdokujt, sepse kërkim – falja është edukatë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – deklaroi se sekretaria e kuvendit e ka një udhëheqës dhe kryesuesja e kuvendit është udhëheqës i sekretarisë. Prandaj, nuk mund t'i ikësh përgjegjësisë në këtë formë dhe duhet ta keni në menaxhim sekretarinë e kuvendit. Sekretaria e kuvendit nuk ka të drejtë pa autorizimin e juaj të dërgojë e-maila, pyetje, raporte nëpër ministri qysh do vetë. Kurse, përgjegjësinë nuk e merr sekretaria, por kryesuesja e kuvendit. Prandaj, analizo këtë se po flasim për sekretarinë e kuvendit dhe s'po flasim për resorë tjerë të komunës

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyetar i komunës** – sa i përket propozim – vendimit për ndarjen e subvencioneve, sigurisht që është duke u përgatitur dhe do të vjen për seancën e kuvendit. Por, para se të vjen në kuvend, ne e kemi planifikuar që të mbajmë një mbledhje të KPF-së para kuvendit, ftesa përmes kryesueses (sipas kërkësës së kryetarit) do ju vjen të gjithëve. Po ashtu, jemi duke i planifikuar edhe të hyrat e bartura, në mënyrë që mos të vonohemi me procedurat e prokurimit.

Sa i përket sekretarisë së kuvendit, është organogrami i komunës që është i votuar nga kuvendi i komunës. Sekretaria e kuvendit në njëfarë forme është institucion në vete dhe nuk udhëheqet nga kryesuesja e kuvendit. Kryesuesja e kuvendit është e thirrur për diçka tjetër që e obligon Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statuti dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe Organeve të Tij. Sa u përket mëditjeve, është zyra e kuvendit, pastaj Drejtoria për Buxhet dhe Financa që i procedon në Ministri të Financave. Kështu që, kryesuesja e ka marrë përgjigjen nga MAPL-ja dhe sigurisht që do të procedohen sipas ligjit në fuqi.

**Komiteti për Politikë dhe Financa me tetë (8) vota “për” e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022>.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, dy (2) “kundër” e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve në Komunën e Vushtrrisë >.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa me tetë (8) vota “për” e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kioskave nga druri për më pak se një vit >.**

*Komiteti për Politikë dhe Financa me tetë (8) vota “për” e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit>.*

*Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit>.*

*Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” aprovoi këtë:*

#### R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.1.2023;
  2. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim;
  3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë;
  4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
  5. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në reportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit;
  6. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë;
  7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022;
  8. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022;
  9. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
  10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësrejtoreve në Komunën e Vushtrrisë;
  11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kioskave nga druri për më pak se një vit;
  12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit;
  13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit;
  14. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.1.2023.

*Komiteti për Politikë dhe Financa me tetë (8) vota “për” aprovoi procesverbalin e datës 16.1.2023.*

2. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – deklroi se neni 19, pika 2 <përbërja e komisionit> nuk është propozuar asnjë anëtar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Në

rregulloren e mëhershme ka qenë një anëtarë nga kjo drejtori. Për shkak të specifikave që ka kjo drejtori dhe i njeh organizatat buxhetore ose OJQ-të që ka me i përkah dhe që kanë aktivitete, konsideroj që kjo drejtori duhet ta ketë një anëtar në komision.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tetë (8) vota “për”, rekomandoi që të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndarjen e Bursave për Nxënës/Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës/Studentë të Komunës së Vushtrrisë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tetë (8) vota “për”, rekomandoi që të procedohet përvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – tha se këtu është mirë të merret një qëndrim vetëm për ditën e diele, që sipas kësaj draft – rregulloreje parashihet që të jetë ditë pushimi. Siç e dimë, komuna ka filluar ta zbatojë vendimin që e diela të jetë ditë pushimi, por ka paraqitur probleme edhe në furnizim për qytetarët, por edhe në humbje financiare për bizneset e caktuara. Duke parë ankesat e shumta, kryetari i komunës e ka pezulluar vendimin dhe ka lejuar që edhe e diela të jetë ditë pune.

Ai propozoi që dita e diel aktualisht mos të jetë pushim dhe të shohim në rrethanat tjera se çka po vendosin qytetet tjera. Kjo çështje duhet të rregullohet nga niveli qendror. Nuk kemi nevojë të bëjmë eksperimente. Ai tha se vërejtje tjetër kisha tek sipërfaqja prej  $50\text{m}^2$  në pompat e derivateve, që për mua është diskriminues dhe duhet të përmirësohet (hiqet)

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – ne si grup vazhdojmë të qëndrojmë prapa propozimit që kemi dhënë dhe i bëjmë thirrje kryetarit të komunës që këtë çështje ta ngris në nivelin e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe të bëhet përpjekje që kjo çështje të rregullohet nga niveli qendror. Pra, të bëhet një rregullore unike për të gjitha komunat. Sepse, në mënyrë parciiale është e vështirë të zbatohet, për shkak numrit të vogël të inspektorëve që ka komuna.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se të gjithë ata që i kam takuar si nga pronarët e bizneseve, por edhe punëtorët, kanë kërkuar që ta kenë së paku një ditë pushim, varësisht nga veprimtaria. Unë kam qenë ijtare që marketet e vogla të punojnë të dielen dhe t'iup jepet mundësi më shumë e punës.

Tek neni 7, paragrafi 5 <veprimtaritë afariste që punojnë deri në ora 03:00 të mëngjesit, ajo tha se është kundër që t'iup vazhdohet edhe më tutje orari. Sepse, e kam përjetuar edhe vetë zhurmën e një lokalë në fshatin Bukosh, ku unë banoj. Por, nëse bëhet iu vazhdohet orari shtesë, atëherë tarifa të jetë 50 euro, e jo 30 euro, por edhe që objekti të ketë kushte që mos të krijojë zhurmë jashtë objektit.

Prandaj, unë jam që dita e diel të jetë pushim me disa përmirësimë në draft – rregullore.

**Agron Përçuku, anëtar i KPF-së** – edhe unë jam që e diela të jetë ditë pushimi. Por, me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, të pezullohet për një kohë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike që po mbretëron. Ai pyeti zyrën ligjore lidhur me nenin 22 <pezullimi i përkohshëm i dispozitave të kësaj rregulloreje> se a e lejohet që kryetari i komunës mund ta pezullojë përkohësisht zbatimin e dispozitave të caktuara, kur dihet që kuvendi i komunës është ai që merr vendim.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës** – theksoi se ka qenë edhe më herët kjo draft – rregullore, por e kemi shtyrë me qëllimin më të mirë që ta diskutojmë edhe në një mbledhje të KPF-së. Porpozimin që e kam dhënë në seancë që marketet e vogla deri në të punojnë të dielën, kam pasur reagime (së paku kam 10 kërkesa nga pronarët e marketeve në fshatra) dhe kanë kërkuar që edhe ata të pushojnë të dielën. Lidhur me marketet deri në 50m<sup>2</sup> në pompat e derivateve nuk kemi bërë ndryshim, ndoshta është edhe shumë kjo sipërfaqe, sepse mund të ketë diskriminim ndaj të tjerëve.

Lidhur me nenin 22 – pezullimi, është kuvendi ai që mund ta autorizojë kryetarin e komunës për pezullimin e rregullores.

**Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore** – e tha nënkyrytari i komunës, kryetari i komunës duhet të autorizohet nga kuvendi për një gjë të tillë.

**Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** – propozoi që marketet në kuadër të pompave të derivateve të paguajnë taksë vjetore prej 600 euro, por edhe të specifikohet se çka mund të shesin.

**Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së** – drejtori i bujqësisë po kërkon taksë vjetore për marketet në kuadër të pompave të derivateve, a në anën tjetër atij i ka shkuar buxheti në suficit në vlerë afër 500 mijë euro. Më së paku i takon drejtorit të kérkoj diçka, kur mjetet në drejtori i kanë tepruar dhe e ka dëmtuar buxhetin e komunës, e ka dëmtuar ekonominë bujqësore, duke mos i financuar projektet.

Ai për seancë kérkoi raport analistik nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

**Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural** – asamblisti Azemi po pretendon që buxheti im ka shkuar në suficit rrëth 500 mijë euro, kurse i tërë buxheti i drejtorisë ka qenë 460 mijë euro. Prandaj, pretendimet se ka shkuar buxheti në suficit në këtë vlerë nuk qëndron. Në kuadër të drejtorisë figuron edhe bashkëfinancimi, por nuk është buxhet i drejtorisë. Prandaj, e kam shpenzuar buxhetin e planifikuar në tërsi (460 mijë euro), tha ai.

**Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë për Inspektore (anëtar i komisionit për hartimin e draft – rregullores)** – deklaroi se propozimi që të bëhet një rregullore unikë për të gjitha komunat është ide e mirë, por se di a ka bazë ligjore. Ligji për Tregti të Brendshme thotë që secila komunë e organizon orarin e punës së bizneseve. I kam shikuar disa rregullore të komunave, ku shumica prej tyre e kanë ditë pushimi të dielën.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – tek neni 12, paragrafi, është dashur të analizohet se a duhet lejuar apo jo të punojnë të dielave ordinancat dhe klinikat private. Ai tha se nëse laboratoret private nuk punojnë të dielave, atëherë qytetarët duhet për një pasqyrë të gjakut të orientohen diku tjetër.

Po ashtu, tek neni 10, paragrafi 3, <tregu i kafshëve punon vetëm ditën e premte prej orës 07:00 – 15:00> Është mirë që t'i shtohet ose këtij paragrafi, ose të bëhet një paragraf i ri dhe të ceket < me përashtim të javës së Kurban Bajramit>.

Tek neni 18, të specifikohet se për cilat veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike është fjala.

Po ashtu, tek neni 14 – ai propozoi edhe barnatoret bujqësore ta kenë një orar kujdestarie.

**Nexhmedin Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** – deklaroi se vetë punëtorët e ordinancave private nuk janë të interesuar të punojnë të dielave.

**Alban Bajrami, anëtar i KPF-së** – tha se sallonet e ondulimit është mirë të përcaktohen se a do të jetë dita e martë apo e diele pushim për to.

**Shpëtim Zhegrova, Nënkyrytar i komunës** – tha se e kemi pasë një konsultim publik dhe pikërisht nga sallonet e ondulimit ka qenë pjesëmarrja më e madhe. Mbi 90% e tyre janë deklaruar që e diela të jetë ditë pushimi, përvèç sezonës 1 qershori – 30 shtator.

**Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

5. Shqyrtimi i Raportit periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

6. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2022 në Komunën e Vushtrrisë.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – nëse ka mundësi që për kuvend të bashkëngjitet një informatë shtesë lidhur me transportin e pacientëve me dializë. Përndryshe, në aspektin teknik kjo informatë është mirë e punuar.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

8. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

9. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.**

10. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për emërim të komisionit për përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve në Komunën e Vushtrrisë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”, një (1) “kundër” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe kioskave nga druri për më pak se një vit.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshim dhe plotësim të vendimit.

**Sylejman Mehollı, anëtar i KPF-së** – lidhur me formulimin <pushon të jetë anëtarë>, është mirë të rregullohet për kuvend.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

13. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për” rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

14. Të ndryshme.

**Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroit se gjatë muajit janar, secili anëtarë i kuvendit e ka pasë në adresën elektronike një kërkesë për bashkëpunim me organizatën DEMOS për monitorim të kuvendit. Lidhur me këtë nuk kam marrë përgjigje. DEMOS-i ka kërkuar që të kontaktojë me grupet kuvendare. Prandaj, nga LDK e VV nuk kam marrë ende përgjigje dhe sot e kemi afatin e fundit për t’iu kthyer përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Bujar Klinaku

  
Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi

  
Kryesuese e KK-së dhe e KPF-së